Dep. DPC|DMP
Nr. Prot. 03-2793/12
Nr. faqe 02
Data 03-08-2012

**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**
**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRIZREN/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U PRIZRENU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRIZREN**

Nr.488-05/2012

**GJYKATA KOMUNALE PER KUNDERVAJTJE NE PRIZREN**, me gjykatesen Vjollca Buzhalen e me procesmbajtesen Firdeze Santurin, ne proceduren kundervajtese kunder te pandehurit Enis Subi nga Prizreni , per shkak te kundervajtjes nga neni 5 ,6par 1.3 si dhe nenin 9 te Ligjit nr. 04/L -050 Per deklarimin , prejardhjen dhe kontrollimin e pasurisë të zyrtarëve te lartë public dhe deklarimin , prejardhjen dhe kontrollimin e dhuratave per te gjithe personat zyrtarë,e ne baze te nenit 195 te LMK-se me dt.09.07.2012 mori kete

**A K T V E N D I M**

**PEZULLOHET** procedura kundervajtese kunder te pandehurit Enis Subi nga Prizreni ruga Istriotet nr. 10., per shkak te kundervajtjes nga neni 5 ,6par 1.3 si dhe nenin 9 te Ligjit nr. 04/L -050 Per deklarimin , prejardhjen dhe kontrollimin e pasurisë të zyrtarëve te lartë public dhe deklarimin , prejardhjen dhe kontrollimin e dhuratave per te gjithe personat zyrtarë,

-konform nenit 198 al.1 p.8 te LMK-se pasi qe nuk ka prova se I pandehuri ka kryer kundervajtjen.

Shpenzimet e procedures kundervajtese bijne ne bare te mjeteve buxhetore te kesaj gjykat

**A r s y e t I m**

Sipas kerkeses se AKK në Prishtinë , me nr.01-1902/2012 te dt.24.05.2012 eshte ngritur procedura kundervajtese kunder te pandehurit Enis Subi nga Prizreni, per shkak te kundervajtjes se lartecekur ne dispozitiv te aktvendimit.

I pandehuri ne seancen verbale te mbajtur me dt.05.07.2012 ka mohuar kundervajtjen me te cilin ngarkohet duke theksuar se nuk e shte e vertete se nuk kam deklaruar prejardhjen e pasurise si zyrtar I larte public . Unë formularin per deklarimin e pasurisë e kam dorzuar ne Agjensionin antirkorupsion me dt. 29.03.2012 dhe si prove materijale gjykates ia deponoj vertetmin e leshur nga AKK të dt. 29.03.2012 me nr. 0319113/20 K .

Andaj ne mungese te provave gjykata ka pezulluar proceduren kundervajtese ndaj te pandehurit Enis Subi nga Prizreni per shkak te kundervajtjes nga neni 5 ,6 par 1.3 si dhe nenin 9 te

Ligjit nr. 04/L -050 Per deklarimin , prejardhjen dhe kontrollimin e pasurisë të zyrtarëve te lartë publik dhe deklarimin , prejardhjen dhe kontrollimin e dhuratave per te gjithe personat zyrtarë, e ne kuptim te nenit 198 al.1 p.8 te LMK_se.

Nga sa u tha me larte u vendos si ne dispzitiv te ketij aktvenimi.

GJYKATA KOMUNALE PER KUNDERVAJTJE NE PRIZREN
Nr.488/2012-05
dt.09.07.2012

Procesmbajtesja
Firdeze Santuri

Gjykatesi per kundervajtje
Violleta Buzhala

UDHEZIMI JURIDIK:Kunder ketij aktvendimi e ne afat prej 8 ditesh mund te ushtrohet ankese Gjykates se Larte per kundervajtje ne Prishtine, nepermes kesaj gjykata pa taksa.